



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

01-1649

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-220242/22 dt. 12.10.2022, të kërkuësve / bashkëpronarëve, Armend Skeja, Prime Group Construction sh.p.k., Argona Kajtazi, Blerim Potera, Valon Budima, Besnik Limaj, Arbnor Polloshka, Arben Polloshka, Bekim Berisha, Feride Lushaku, Agim Aliqkaj, Kimet Zeqa, Arben Saliu, Vehdet Pruthi, Visar Gacaferri, Lulzim Zeka, Ilir Bajri dhe Gazmend Bajri nga Prishtina, dhe Investitorit “Prime Group Construction” sh.p.k. me seli në Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “Prime City 01” me lamellat “A”, “B”, “C” dhe “D” e ndërtuara, në kuadër të parcelës ndërtimore “E11-2”, të bllokut urban “E11”, të tërsisë hapësinore “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në rr. “Mali i Çikës” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 01.12.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuësve / bashkëpronarëve, Armend Skeja, Prime Group Construction sh.p.k., Argona Kajtazi, Blerim Potera, Valon Budima, Besnik Limaj, Arbnor Polloshka, Arben Polloshka, Bekim Berisha, Feride Lushaku, Agim Aliqkaj, Kimet Zeqa, Arben Saliu, Vehdet Pruthi, Visar Gacaferri, Lulzim Zeka, Ilir Bajri dhe Gazmend Bajri nga Prishtina dhe Investitorit “Prime Group Construction” sh.p.k. me seli në Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-220242/22 dt. 12.10.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “Prime City 01” me lamellat “A” me etazhitet B+P+7, “B” me etazhitet B+S+P+6, “C” me etazhitet 2B+P+6 dhe “D” me etazhitet 2B+P+6, e ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/05-0148984/18 dt. 11.09.2018, në parcelën kadastrale nr. 10217-1, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10217-1, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës ndërtimore “E11-2”, të bllokut urban “E11”, të tërsisë hapësinore “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Mali i Çikës” ku ka dalje hyrjet me numrat: 7, 9, 11, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 39, 47, 53 në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësisve të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuësit / bashkëpronarët, Armend Skeja, Prime Group Construction sh.p.k., Argona Kajtazi, Blerim Potera, Valon Budima, Besnik Limaj, Arbnor Polloshka, Arben Polloshka, Bekim Berisha, Feride Lushaku, Agim Aliqkaj, Kimet Zeqa, Arben Saliu, Vehdet Pruthi, Visar Gacaferri, Lulzim Zeka, Ilir Bajri dhe Gazmend Bajri nga Prishtina dhe Investitorit “Prime Group Construction” sh.p.k. me seli në Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 391/02-220242/22 dt. 12.10.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “Prime City 01” me lamellat “A” me etazhitet B+P+7, “B” me etazhitet B+S+P+6, “C” me etazhitet 2B+P+6 dhe “D” me etazhitet 2B+P+6, e ndërtuara, në kuadër të parcelës ndërtimore “E11-2”, të bllokut urban “E11”, të tërsisë hapësinore “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona

Faqe 1 prej 2

Vendimi për Lëshimin e Ndërtimit, 05 NR. 391/02-214808/21 dt. 08.10.2022, të reshtuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit, e Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-214808/21 dt. 08.10.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/1.Inspeksioni i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.1.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.2.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.c.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.d.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/3.Inspeksioni i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/4.Inspeksioni i instalimeve të ujit; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Bajram Sinani; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Arsim Rapuca; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Lirie Beka; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikëqyrësi Skender Rugova; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Gazmend Krasniqi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompanija gjeodete e licensuar "GeoHorizont" shpk me nr. të licensës 54;

Drejtorja e Urbanizimit, pas pranimit të kësaj kërkesë dhe shqyrtimit të saj, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspeksionit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZIMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-220242/22 DT. 01.12.2022**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi
Nazife Krasniqi



Page 2 prej 2